

BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Viti 2025


Gjatë vitit 2025, energjia elektrike në dispozicion arriti në 8.345 GWh, kundrejt 8.171 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 2,1 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike arriti vlerën 7.468 GWh, nga 7.837 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej 4,7 %.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 45,2%, nga prodhuesit privatë dhe koncesionarë në masën 41,6% dhe nga të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera) në masën 13,2% të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje) arriti vlerën 3.375 GWh, nga 2.669 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 26,5%. Ndërkohë, **eksporti bruto** i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 2.498 GWh, nga 2.335 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 7,0% (tab.1).

FIG. 1 ENERGJI NË DISPOZICION, PRODHIMI NETO VENDAS, IMPORTI DHE EKSPORTI BRUTO



TAB. 1 BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE, 2024-2025

Treguesit		(MWh)	
		2024	2025
A	Energji në dispozicion (A=1+2-3)	8.170.517	8.345.057
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	7.836.625	7.467.589
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	7.330.077	6.483.521
a	Publike (a=a.1-a.2)	4.084.914	3.374.386
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	4.124.239	3.404.932
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	39.325	30.547
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	3.245.163	3.109.135
1.3	Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	506.548	984.068
2	Importi bruto (energji në marrje)	2.668.771	3.375.269
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	2.334.878	2.497.802
B	Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	8.170.517	8.345.057
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	1.614.264	1.592.955
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	201.342	193.469
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	1.412.922	1.399.486
a	Humbjet teknike në shpërndarje	997.284	1.008.994
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	415.638	390.492
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	6.556.253	6.752.103
2.1	Familjarë	3.408.870	3.641.101
2.2	Jo Familjarë	3.147.383	3.111.002

¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike

² Humbjet jo teknike përmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Hidrocentralet publike, në vitin 2025, prodhuan 3.374 GWh, nga 4.085 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rënie të prodhimit prej 17,4%.

Prodhuesit privatë dhe koncesionarë prodhuan 3.109 GWh, nga 3.245 GWh një vit më parë, duke shënuar një rënie prej 4,2%.

Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera) prodhuan 984 GWh, nga 507 GWh në vitin 2024, duke regjistruar një rritje prej 94,3%.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në vitin 2025, rezultoi negativ në nivelin -877 GWh, krahasuar me një nivel negativ prej -334 GWh në vitin 2024 (fig.2).

FIG. 2 SHKËMBIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE




Humbjet në rrjet arritën vlerën 1.593 GWh në vitin 2025, nga 1.614 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej 1,3%.

Pesha që zënë **humbjet në rrjet** në totalin e energjisë elektrike në dispozicion gjatë vitit 2025 është 19,1%, kundrejt 19,8% në vitin 2024, duke regjistruar një ulje prej 0,7 pikë përqindje.

Gjatë vitit 2025, **humbjet në transmetim** shënuan rënie prej 3,9%, ndërsa humbjet në shpërndarje shënuan rënie prej 1,0%, krahasuar me vitin 2024 (fig.3).


FIG. 3 KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE, HUMBJET NË RRJET DHE PËRDORIMI NGA KONSUMATORËT




Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në vitin 2025, arriti vlerën 6.752 GWh, nga 6.556 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 3,0%.

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë u rrit me 6,8%, duke arritur vlerën 3.641 GWh në vitin 2025, nga 3.409 GWh në vitin 2024.

Ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u ul lehtë, duke arritur 3.111 GWh në vitin 2025, nga 3.147 GWh në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej 1,2% (fig.4).

FIG. 4 PËRDORIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KONSUMATORËT

Në fig.5 paraqitet struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve për periudhën 2021–2025. Gjatë vitit 2025, prodhimi neto vendas paraqet rritje të ndjeshme në tremujorin e katërt krahasuar me vitin 2024, ndërsa shënon ulje në tre tremujorët e tjerë krahasuar me një vit më parë.

FIG. 5 STRUKTURA NË PËRQINDJE E PRODHIMIT NETO VENDAS SIPAS TREMUJORËVE, 2021 - 2025 (%)

Tremujori IV 2025

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025, **energjia elektrike në dispozicion** arriti në 2.208 GWh, kundrejt 2.128 GWh në të njëjtin tremujor të vitit 2024, duke shënuar një rritje prej 3,8%.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike arriti vlerën 2.402 GWh, nga 1.953 GWh në tremujorin e katërt të vitit 2024, duke regjistruar një rritje të ndjeshme prej 23,0% (tab.2).

TAB. 2 BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE, TREMUJORI IV

MWh

Treguesit	Tr. IV 2024	Tr. IV 2025
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	2,128,077	2,208,422
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	1,953,147	2,401,808
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	1,826,386	2,193,552
a Publike (a=a.1-a.2)	1,014,176	1,061,559
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	1,024,108	1,070,866
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	9,932	9,306
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	812,210	1,131,992
1.3 Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	126,760	208,256
2 Importi bruto (energji në marrje)	748,626	622,889
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	573,695	816,274
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	2,128,077	2,208,422
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	464,491	472,148
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	51,727	53,370
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	412,764	418,778
a Humbjet teknike në shpërndarje	263,978	271,164
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	148,786	147,614
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1,663,586	1,736,275
2.1 Familjarë	881,729	956,087
2.2 Jo Familjarë	781,857	780,188


¹ Të tjerë prodhues i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshiruar energjinë hidro dhe term (fotovoltaikë, naftë, etj)

² Detajimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

³ Humbjet jo- teknike përmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit..


Gjatë të njëjtës periudhë, **importet bruto** të energjisë elektrike (energji në marrje) u ulën me 16,8%, ndërsa **eksportet bruto** të energjisë elektrike (energji në dhënie) u rritën me 42,3%, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2024 (fig.6).

FIG. 6 ENERGJI NË DISPOZICION, PRODHIMI NETO VENDAS, IMPORTI DHE EKSPORTI BRUTO



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në tremujorin e katërt të vitit 2025, u rrit me 4,4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. **Përdorimi nga konsumatorët familjarë** u rrit me 8,4%, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** mbeti pothuajse në të njëjtin nivel, duke regjistruar një rënie të lehtë prej 0,2% (fig.7).

FIG. 7 KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE, HUMBJET NË RRJET DHE PËRDORIMI NGA KONSUMATOR



Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara vjetore sipas aktiviteteve ekonomike janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Energjia](https://www.instat.gov.al/) si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Bilanci i Energjisë Elektrike](#)

Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;

OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;

OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;

transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;

tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liqensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSSH-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. Humbjet teknike në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSSH sh.a. Humbjet jo teknike i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe dëmi ekonomik i llogaritur për konsumatorët familjarë.

Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përjashtuar konsumin nga familjarët.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe dëmi ekonomik i llogaritur për konsumatorët jo familjarë.